



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
ZYRA PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN**

Rr. Jordan Misja, Blv Zhan d'Ark, Tiranë, adresë web: www.gjykata.gov.al

Datë 13.05.2026

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi interesin e shfaqur nga disa gazetarë, po ju referojmë *informacionin zyrtar të dhënë nga ana e gjyqtarit të çështjes*, si në vijim:

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Doma Civile, në datën 06.05.2026, është paraqitur kërkesa me **Paditëse Mereme Sela** me objekt: “1. *Shpallja e pavlefshme absolute e vendimit për skualifikimin e paditëses nga gara për Kryetar të PDSH-se; 2. Detyrimi i palës se paditur për rikthimin e paditëses në garë; 3. Shpallja e pavlefshme absolute e kandidimit të Sali Berisha; 4. Konstatimi i shkeljes së rëndë të statutit dhe parimeve të demokracisë së brendshme; 5. Vendosja e masës së sigurimit të padisë: pezullimi i menjëhershëm i procesit zgjedhor të datës 23.05.2026 deri në përfundim të gjykimit”.*

Gjykata ka marrë në shqyrtim brenda afatit ligjor kërkesës e paraqitur, ka studiuar dhe vlerësuar aktet e paraqitura dhe në përfundim ka vendosur: “Kthimin e akteve me të meta, që i përkasin kërkesëpadisë, duke i dhënë paditëses të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, siaps parashikimeve ligjore.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

e-mail: ola.ismaili@gjykata.gov.al